



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

1. Emri i Institucionit:	Zyra Kombëtare e Auditimit
2. Titulli:	Zyrtar i Lartë Ekzekutiv
3. Kodi Buxhetor:	13400
4. Kategoria Funktionale:	Nivel Profesional
5. Grada/Koeficienti:	N/A
6. Lloji i vendit të punës:	Shërbyes Civil i Karrierës
7. Njësia Organizative:	Kabineti i Auditorit të Përgjithshëm
8. Raporton tek:	Udhëheqësi i Kabinetit të Auditorit të Përgjithshëm
9. Lokacioni:	Prishtinë

10. Qëllimi i Pozitës:

Mbështetja profesionale për Auditorin e Përgjithshëm për organizim dhe koordinimin e aktiviteteve për realizimin dhe përmbushjen e përgjegjësisë të tij.

11. Detyrat Kryesore: (përshkrim i shkurtë i detyrave kryesore të radhitura sipas rëndësisë së tyre).

Detyra 1: Ndhmon në organizimin e punës dhe menaxhimin efikas të aktiviteteve të përditshme të kabinetit të Auditorit të Përgjithshëm dhe ndërlihdjen e departamenteve dhe njësive tjera organizative të ZKA-së me kabinetin e AP-së; 20%

Detyra 2: Ofron këshilla profesionale dhe ndihmon realizimin e agjendës së punës për Udhëheqësin e Kabinetit në zhvillimin dhe arritjen e objektivave të punës; 15%

Detyra 3: Harton shkresa, vendime, udhëzime dhe akte tjera për Kabinetin e Auditorit të Përgjithshëm; 15%

Detyra 4: Bashkëpunon me udhëheqësit e divizioneve, departamenteve, dhe njësive të tjera të ZKA-së sipas udhëzimeve të Auditorit të Përgjithshëm lidhur me koordinimin për realizimin e aktiviteteve të tyre; 15%

Detyra 5: Merr pjesë në mbledhjet e ndryshme të Auditorit të Përgjithshëm, mban shënime dhe harton procesverbale sipas nevojës; 10%

Detyra 6: Siguron klasifikimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e akteve dhe dokumenteve në Kabinetin e Auditorit të Përgjithshëm; 10%

Detyra 7: Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet organizative dhe çështjeve që kërkojnë shqyrtim nga Auditori Përgjithshëm;10%

Detyra 8: Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5 %

12. Përgjegjësia Mbikëqyrëse (Po/Jo)

JO

13. Përgjegjësia Financiare: (Po/Jo)

JO

14. Kualifikimet themelore:

- Fakulteti juridik, administratë publike ose ekonomik;
- Tri vite përvojë pune profesionale;

15. Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën hartimit mbikëqyrjes së zbatimit të politikave dhe ligjshmërisë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).
- Njohja e mirë e gjuhës angleze, e dëshirueshme;

16. Nënshkrimet dhe Aprovimet

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------

Përgjegjësi për Burime Njerëzore

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------

Auditori i Përgjithshëm

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------